



KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE
KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

**THIRRJE PËR APLIKIM PËR TRAJNERË PËR DHËNIE TRAJNIMI PËR
ADMINISTRATËN ZGJEDHORE**

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve kërkon të kontraktojë 13 trajnerë, për dhënie trajnimi për administratën zgjedhore për zgjedhjet e pjesshme vendore për kryetar bashkie në disa njësi të qeverisjes vendore, të datës 06 Mars 2022, përkatësisht:

1. Bashkia Shkodër, 3 trajnerë

Trajnuesi nr. 1 për KZAZ nr. 2, do të trajnojë 97 QV; Njësitë administrative: (Ana e Malit, Shalë, Shosh, Bërdicë, Dajç, Guri i Zi, Pult, Postribë, Rrethinat)

Trajnuesi nr. 2 për KZAZ nr. 2, 3 dhe 4, do të trajnojë 75 QV; Njësitë administrative: (Velipojë dhe Shkodër - qytet)

Trajnuesi nr. 3 për KZAZ nr. 4, do të trajnojë 78 QV; Njësia administrative: (Shkodër - qytet)

2. Bashkia Dibër, 2 trajnerë

Trajnuesi nr. 1 për KZAZ nr. 19, do të trajnojë 56 QV; Njësitë administrative: (Peshkopi-qytet, Lurë, Zall - Dardhë, Zall - Reç, Selishtë)

Trajnuesi nr. 2 për KZAZ nr. 19, do të trajnojë 45 QV; Njësitë administrative: (Luzni, Melan, Maqellarë, Sllovë dhe Tomin)

3. Bashkia Vorë, 1 trajner

Trajnuesi nr. 1 për KZAZ nr. 26, do të trajnojë 44 QV; Njësitë administrative: (Vorë – qytet, Bërshullë dhe Prezë)

4. Bashkia Rrogozhinë, 1 trajner

Trajnuesi nr. 1 për KZAZ nr. 43, do të trajnojë 53 QV; Njësitë administrative: (Gosë, Kryevidh, Lekaj, Rrogozhinë- qytet, Sinaballaj)

5. Bashkia Lushnjë, 2 trajnerë

Trajnuesi nr. 1 për KZAZ nr. 54, do të trajnojë 70 QV; Njësitë administrative: (Allkaj, Bubullimë, Dushk, Ballagat, Hysgjokaj, Kolonjë, Fier Shegan dhe Golem)

Trajnuesi nr. 2 për KZAZ nr. 54 dhe 55, do të trajnojë 87 QV; Njësitë administrative: (Karbunarë, Krutje dhe Lushnje – qytet)

6. Bashkia Durrës, 4 trajnerë

Trajnuesi nr. 1 për KZAZ nr. 21, do të trajnojë 76 QV; Njësitë administrative: (Sukth – qytet,



Ishëm, Manëz dhe katundi i ri)

Trajnuesi nr. 2 për KZAZ nr. 21 dhe 22, do të trajnojnë 91 QV; Njësiti administrative: (Rrushbull dhe Durrës – qytet)

Trajnuesi nr. 3 për KZAZ nr. 22 dhe 23, do të trajnojnë 96 QV; Njësia administrative: (Durrës – qytet).

Trajnuesi nr. 4 për KZAZ nr. 23 dhe 24, do të trajnojnë 74 QV; Njësia administrative: (Durrës – qytet).

Shënim: Në këtë ngarkesë nuk është përfshirë ngarkesa që do të ketë trajnuesi për trajnimin e kryetarit dhe sekretarit të KQV-ve.

KQZ është e interesuar edhe për kontraktimin e dy trajnerëve profesionistë për trajnimin e administratës zgjedhore online si pjesë e administratës së KQZ me kohë të pjesshme.

Përshkrimi i detyrave kryesore të trajnerit:

- ✓ Trajnim i administratës zgjedhore të përcaktuar nga KQZ;
- ✓ Monitorim i performancës së administratës zgjedhore që trajnon dhe të qendrave të votimit vetëm me kërkesë të KQZ
- ✓ Planifikim të trajnimeve dhe aftësi kordinuese për realizimin e tyre
- ✓ Praktikon metoda të trajnimit që sigurojnë përfshirjen aktive të gjithë pjesëmarrësve në trajnim;
- ✓ Aftësi për të udhëhequr diskutimet duke ruajtur klimën pozitive;
- ✓ Ofron udhëzime të qarta në procedurat dhe aktivitetet gjatë seancave të trajnimit, për arritjen e rezultateve të moduleve të trajnimit;
- ✓ Përdorimi i TIK për të vizualizuar përmbajtjen e moduleve;
- ✓ Dokumenton dhe raporton për zhvillimin e trajnimit, sipas kërkesave të KQZ-së.
- ✓ Dokumenton dhe raporton për parregullsitë e verejtura gjatë ushtrimit të detyrave të administratës zgjedhore në zonën e tij të trajnimit/ monitorimi;

Kriteret që duhet të plotësojnë aplikantët:

1. Formimi universitar i ciklit të dytë sipas ligjit nr.80/2015 “Për arsimin e lartë dhe Kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, në fushën e edukimit, drejtësisë, shkencave politike, komunikimit, etj.



2. Përvojë në mësimdhënie jo më pak se 6 vite në institucionet e arsimit të lartë apo në institucionet parauniversitare të arsimit të mesëm të lartë, apo i angazhuar si trajner nga organizatat e njohura vendase apo ndërkombëtare, mundësisht me një eksperiencë si trajner në proceset zgjedhore të mëparshme. Për trajnerët profesionistë përvoja duhet të jete jo më pak se 10 vjet;
3. Preferohen kandidatë të cilët banojnë në bashkitë në të cilat zhvillohen zgjedhjet;
4. Pesë vitet e fundit të mos ketë qënë i zgjedhur në organet drejtuese qendrore dhe vendore të partive politike dhe të mos ketë patur aktivitet të deklaruar publik në fushatë zgjedhore ose aktivitetin politik të një subjekti zgjedhor;
5. Të mos jetë në detyrë në strukturat e organeve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës, inspektoriat qendror apo lokal, ushtarak aktiv i Forcave të Armatosura, punonjës i Shërbimit Informativ, organeve të pushtetit gjyqësor;
6. Të mos jetë i dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë;
7. Të mos jetë i dënuar administrativisht për shkelje të dispozitave, të cilat lidhen me zgjedhjet, apo të mos ketë masë disiplinore në fuqi në shërbimin civil;
8. Nëse aplikanti është nëpunës civil, pozicion të barazvlefshëm me të, apo funksionar publik duhet të dorëzojë edhe lejen nga titullari i institucionit për lejimin e tij në kryerjen e kësaj veprimtarie për periudhën e kërkuar;
9. Të ketë aftësi komunikimi, menaxhimi dhe raportimi, si dhe të përdorë lehtësisht programet bazë kompjuterike.

Aplikimi:

Aplikantët duhet të dorëzojnë dokumentacionin brenda datës 28.01.2022.

Aplikimet të bëhen online në linkun bashkëlidhur:

<https://forms.gle/zozhjFWLYLjW1f58>

Dokumentacioni:

1. Kërkesë e nënshkruar e aplikantit si dhënës të trajnimit në qarkun/bashkinë përkatëse;
2. Kopje të dokumentit të identifikimit (kartë identiteti/pasaportë);
3. Jetëshkrim (CV), ku të pasqyrohet adresa e postës elektronike dhe numri telefonik i kontaktit;
4. Diplomë e arsimit të lartë (e noterizuar);
5. Kopje e librezës së punës (e noterizuar);
6. Çertifikatë personale të lëshuar nga zyra e gjendjes civile apo nga portali e-albania;



7. Çertifikatë kualifikimi, trajnimi ose dokument tjetër, që vërteton eksperiencën si trajnerë (nëse ka);
8. Deklaratë e nënshkruar për përmbushjen e kriterëve të përzgjedhjes, pikat 3, 4, 5, 6.
9. Vërtetim nga institucionet ku janë të punësuar për përmbushjen e kriterëve të përzgjedhjes, pikat 7 dhe 8.

KQZ brenda një dite do të njoftojë aplikantët të cilët përmbushin kriteret si dhe kanë depozituar dhe provuar përmes dokumentacionit përmbushjen e tyre, për fillimin e trajnimit të tyre.

Në përfundim të trajnimit, kandidati për trajner i nënshtrohet testimit. Testimi quhet i kaluar nëse kandidati vlerësohet 70 pikë nga 100 të mundshmet. KQZ sipas nevojës që ka shpallur, do të njoftojë kandidatët, duke i renditur sipas rezultatit të testimit, për të lidhur kontratën me KQZ.

